



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT**  
**MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I ŽIVOTNE SREDINE**  
**MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT**

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary*

DATË/A:	25.02. 2020
REFERENC-Ë:	20/167/MIA
PËR/ZA/TO:	"Euro Metal H" Sh.p.k. Brestovik, Pejë.
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi Sekretar i Përgjithshëm i MIA
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 20/167/MIA dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për, Qendrën për grumbullimin dhe seleksionimin e mbeturinave metalike në Brestovik, Komuna e Pejës.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 4





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT**  
**MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I ŽIVOTNE SREDINE**  
**MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT**

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary*

Në bazë të nenit 29.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 22 dhe nenit 25 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe nenit 44. të LPA (Nr.05/L-031), Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit, bie këtë:

**V E N D I M**

**APROVOHET** kërkesa e Kompanisë “Euro Metal H” Sh.p.k. Brestovik, Pejë, Qendra për grumbullimin dhe seleksionimin e mbeturinave metalike në Brestovik, Komuna e Pejës.

**A r s y e t i m**

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit ka shqyrtuar kërkesën, Raportin e VNM-së, dokumentacionin e dorëzuar të “Euro Metal H” Sh.p.k. Brestovik, Pejë, Qendra për grumbullimin dhe seleksionimin e mbeturinave metalike në Brestovik, Komuna e Pejës, në pjesën e ngastrës kadastrale nr. P-71611010-00013-2, numri i lëndes se certifikatës 112688, Zona kadastrale Brestovik, Komuna e Pejës.

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-214 për VNM, neni 20, është mbajtur debati publik, dhe me këtë rast, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i **jep Pëlqim Mjedisor**, për Qendrën për grumbullimin dhe seleksionimin e mbeturinave metalike në Brestovik, Komuna e Pejës, nën kushtet si vijon:

- Të bëhet betonimi dhe izolimi i platos ku janë të vendosura mbeturinat metalike;
- Të vendoset sistemi për trajtimin e ujërave të ndotura me vajra dhe ujërave atmosferike të cilat krijohen në sipërfaqet operationale gjatë të reshurave

Faqe 2 nga 4

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave “ Rilindja” kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë  
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks.gov.net/mmph>, E-mail: [zsp.mmph@ks.gov.net](mailto:zsp.mmph@ks.gov.net)





(sedimentuesit dhe separatori për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga uji), para shkarkimit të tyre;

- Të vendosen pajimet adekuate për magazinimin e mbeturinave të ngurta dhe lëngta;
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit, gjatë zbatimit të projektit si dhe pas përfundimit të tij;
- Aplikanti përpos kushteve të lartë cekura të i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lart cekura, pëlqimi do të anulohet (merret).

**Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore**

Ky Pëlqim Mjedisor vlen për dy vite konform nenit 25 te Ligjit për VNM Nr. 03/L-214.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

**Këshilla Juridike:**Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit

Nr.: 20/167/ZSP/72/20 datë: 25.02.2020

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së

Izedin BYTYQI

Sekretar i Përgjithshëm



2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

### **Neni 31.**

#### Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

### **Neni 35.**

#### Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

